

**SHQIPTARËT NËN PERANDORINË OSMANE  
GJATË DEKADËS SË FUNDIT TË SHEKULLIT XVIII  
DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XIX**

Memli Sh. KRASNIQI  
Instituti Albanologjik

Punim studimor

**Përmbajta e shkurtër:** Me Paqen e Karlovci, të vitit 1699, si dhe me Traktatin e Kyçyk Kainarxhisë, të vitit 1774, kishte përfunduar epoka e ekspansionit territorial të Perandorisë Osmane dhe kishte filluar periudha e ndërhyrjes së vendeve evropiane për caktimin e fatit të mëtejshëm të saj, në rend të parë të Perandorisë Habsburgase dhe të Rusisë cariste. Ndërkohë në zonat shqiptare nën Perandorinë Osmane ishte rënduar gjendja ekonomike e sociale e popullsisë dhe një faktor shtesë në përkeqësimin, sidomos të pozitës së fshatarit, ishte edhe procesi i përhapjes së pronës private-çifllëkut, duke shtuar kështu në kurriz të tij edhe taksat e jashtëligjshme. Rrjedhimisht një mundësi e vogël për punësim e kësaj popullate luftarake ishte hyrja në shërbimet ushtarake, qoftë si vullnetar-mercenarë, qoftë në mënyrë të imponuar nga perandoria apo edhe nga feudalët e fuqishëm lokalë. Në anën tjetër, po në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, në hapësirat e banuara me shqiptarë u krijuan pashallëqe autonome, që vetëm formalisht i nënshtroheshin sulltanit.

**Fjalët kyçe:** Karlovci, Kyçyk Kainarxhisë, Perandoria Osmane, Perandoria Habsburgase, Rusia cariste etj.

Me Paqen e Karlovci, të vitit 1699, si dhe me Traktatin e Kyçyk Kainarxhisë, të vitit 1774, kishte përfunduar epoka e ekspansionit territo-

rial të Perandorisë Osmane dhe kishte filluar periudha e ndërhyrjes së vendeve evropiane për caktimin e fatit të mëtejme të saj, në rend të parë të Perandorisë Habsburagase dhe të Rusisë cariste.<sup>1</sup> Kjo epokë historike, që shënoi fundin e luftërave pushtuese, në thelb përcakton edhe fillimin e shthurjes së sistemit feudalo-ushtarak të Perandorisë Osmane. Shkak i shthurjes së kësaj perandorie ishin bërë edhe mungesat financiare që për burim kishin plaçkitjet, të cilat, pothuaj, kishin marrë fund e me këtë edhe spahinj të kishin humbur interesimin për t'iu përgjigjur thirrjes së Sulltanit. Në të njëjtën kohë kishte filluar edhe shndërrimi i timareve në prona feudale, duke e shfuqizuar kështu edhe më tepër bazën financiare e ushtarake të Perandorisë. Në tërë këtë rënie të madhe kishte kontribuar edhe zhvendosja e rrugëve detare nga Mesdheu në Oqeanin Atlantik, duke i reduktuar kështu dukshëm të ardhurat perandorake nga taksat e mallrave të Lindjes, të cilat shkonin drejt Evropës Perëndimore. Në analizën e rrethanave sociale dhe ekonomike në Perandorinë Osmane e sidomos ato në viset shqiptare, duhet pasur parasysh edhe faktorin gjeografik dhe kushtet e vështira sanitare që mbretëronin në ato anë. Kështu 3/4 e territorit të sotëm të Shqipërisë politike ishin vise të mbuluara me pyje, kurse pjesa tjetër toka moçalike. Hapësirat e tjera shqiptare si: Kosova, Maqedonia Perëndimore dhe Greqia Veriore kishin një bujqësi intensive dhe ekstensive, që reflektonin gjithnjë në kërkesa për toka të reja bujqësore. Sëmundjet e ndryshme kishin nxitur popullatën e këtyre vendeve që të merrnin rrugën e shpërnguljes. Është e njohur në këtë kontekst, historia e hidhur e rripit fushor ndërmjet Durrësit dhe Vlorës, i cili gjatë shekujve XVIII-XIX ishte bërë qendra e malaries. Ndërsa gjatë gjithë shekullit XVIII, në viset ndërmjet Janinës, Shkodrës dhe Prizrenit vazhdonte të mbretëronte epidemia e murtajës, derisa në rajonet malore popullsia vuante nga sëmundjet të lidhura për kafshët. Gjithashtu një faktor shtesë në përkeqësimin e situatës ekonomike të fshatarit ishte edhe procesi i përhapjes së pronës private-çifllëkut, duke shtuar kështu në kurriz të tij edhe taksat e jashtëligjshme.<sup>2</sup> Meqenëse sëmundjet, krahas njerëzve, goditnin edhe kafshët, përhapja e epidemive thellonte edhe më

<sup>1</sup> *Historia e popullit Shqiptar*, vëll. I (Prishtinë: Rilindja, 1979), 362.

<sup>2</sup> Frederic F. Anscombe, *The Ottoman Balkans 1750-1830* (Princeton: Markus Wiener Publishers, 2006), 93-94-95.

shumë varfërinë, duke vështirësuar punët bujqësore, lëvizjen e lirë, tregtinë dhe transportin e mallrave.<sup>3</sup>

Në kushte të tilla të pavolitshme ekonomike dhe sociale, shqiptarët, ashtu si edhe shumë popuj të tjerë të cilët jetonin kryesisht në zonat malore, ku mundësitë ishin më të pakta për të siguruar ekzistencën, qenë të detyruar që të merrnin rrugën e mërgimit në kërkim të kushteve më të mira për jetë. Natyrisht, shtytës të këtij migrimi ishin edhe faktorë të tjerë, si epidemitë e ndryshme, mungesa dhe zbatimi selektiv i drejtësisë, arbitrariteti i qeveritarëve dhe shtresa e fuqishme dhe e pasur lokale. Gjatë gjithë shekullit XIX, një mundësi e vogël për punësim e kësaj popullate luftarake, ishte hyrja në shërbimet ushtarake, qoftë si mercenarë, qoftë në mënyrë të imponuar nga perandoria apo edhe nga feudalët e fuqishëm lokalë. Malësorët shqiptarë, sikundër edhe ata zviceranë, irlandezë e skocezë një nga burimet ekzistenciale të tyre patën mercenarizmin. Për më tepër këta malësorë, të shquar për guximin e tyre, po të kishin pasur një disiplinë dhe një strateg të aftë për t'i udhëhequr, ndoshta edhe do ta ndryshonin rrjedhën e historisë së Perandorisë Osmane. Kështu shkruanin e bënë me dije shumë udhëpërshkrues të huaj, ndër të cilët edhe konsulli francez në Janinë, Pukëvilli.<sup>4</sup>

Në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, në hapësirat e banuara me shqiptarë u krijuan pashallëqe autonome, që vetëm formalisht i nënshtroheshin sulltanit. Dëshmi për këtë ofrojnë edhe dokumentet fiskale osmane, në të cilat shihet pozita speciale e shqiptarëve. Kështu, në një dokument tatimor osman të vitit 1819, që ka të bëjë me të ardhurat e Valiut nga sanxhaqet e Rumelisë, shihet se sanxhaqet shqiptare ishin të përjashtuara, ngase të ardhurat tatimore në zonat shqiptare mblihdeshin nga sundimtarët lokalë e jo nga zyrtarët e Perandorisë

<sup>3</sup> Memli Krasniqi & Flamur Ukaj, “Gjendja shëndetësore në viset shqiptare gjatë luftërave osmano-austriake në shekujt XVII-XVIII”, *Studime Historike*, no.1-2 (Tiranë: QSA-Instituti i Historisë, 2015), 206.

<sup>4</sup> Fransua Pukëvili, *Në Oborrin e Vezirit të Janinës* (Tiranë, 1999), 16. Lidhur me Ali Pashë Tepelenën, autori William Miller shkruante se ai ishte bërë i njohur në Evropë si “Luani i Janinës” nga poezitë e Lord Bajronit dhe nga proza e Jokai-t. Autori theksonte se Ali Pasha i takonte një familjeje shqiptare nga Tepelena, e cila ishte konvertuar në mysi-manë. Gjyshi i tij ishte vrarë gjatë rrethimit të Korfuzit, më 1716, ndërsa ai ishte bërë sundues i Janinës nga viti 1788. Për më shumë shih: William Miller, *The Ottoman Empire 1801- 1913* (Cambridge: University Press, 1913), 19.

Osmane.<sup>5</sup> Kështu në Shqipërinë bregdetare ishin fuqizuar dy pashallëqe: Pashallëku i Bushatlijve në veri, me kryeqendër Shkodrën, dhe Pashallëku i Ali Pashë Tepelenës, me kryeqendër Janinën. Është koha kur në kushte të një qetësie dhe rregulli të brendshëm në trojet shqiptare, vihet re edhe një lulëzim i qyteteve, që ishte rezultat i zhvillimit të zejtarisë dhe të tregtisë në to. Kjo hapje tregtare ndaj vendeve evropiane nis pas vitit 1699, fillimisht me hapjen e porteve detare të Durrësit, Ulqinit, Vlorës dhe të Artës. Rrjedhimisht, dy qendrat kryesore tregtare në zonat me popullsi shqiptare u bënë Shkodra dhe Voskopoja, prej nga nisën të eksportoheshin leshi, duhani, orizi, vaji i ullirit, kripa, pambuku, mëndafshi, kafshët dhe armët.<sup>6</sup> Ndërsa, në pjesën jugore të vendit kultivoheshin portokalli, limoni, shega, fiku dhe rrushi i cilësisë shumë të mirë.<sup>7</sup> Kështu oficeri francez, Ibrahim Manzur Efendiu, që ishte në shërbim të Ali Pashë Janinës, kishte sjellë nga Korfuzi patatën me shpresën më të mirë se edhe të shqiptarët kjo bimë do të bëhej ushqim i përditshëm, siç ishte bërë për fshatarin evropian, madje edhe simbol mbijetese. Mjerisht, vijonte kujtimet e tija Ibrahim Manzur, shqiptarët nuk e përvetësuan këtë prodhim të vlefshëm, për shkakun se patatja, përveç tjerash, rritet brenda nën tokë.<sup>8</sup> Sidoqoftë, kjo periudhë historike, padyshim, shënonte fundin e epokës së mirëqenies relative ekonomike dhe financiare të një perandorie dikur të fuqishme. Dëshmi të një përfundimi të tillë janë edhe pohimet e Tavernier-it, sipas të cilit, në shekullin XVII, në tregun e Beogradit kishte me bollëk dhe me çmim të lirë; grurë, verë, mish dhe produkte të

<sup>5</sup> *Ottoman rule and the Balkans (1760-1850): Conflict, Transformation, Adaptation*, Antonis Anastasopoulos, Elias Kolovos (Eds.), (Rethymno: University of Crete, 2007), 13.

<sup>6</sup> Frederic F. Anscombe, *The Ottoman Balkans*, 99. Qendër kulturore me rëndësi brenda Perandorisë Osmane ishte edhe Voskopoja, popullsia e së cilës për nga përkatësia etnike ishte shqiptaro-vllahe. Ndërsa Voskopoja, si qytet, pati një hov të lulëzimit kulturor dhe ekonomik gjatë shekujve XVII-XVIII, në kohën kur tregtarët dhe zejtarët e këtij vendbanimi ishin të njohur jo vetëm në Perandorinë Osmane, por edhe jashtë kufijve të saj. Një shembull i mirë për t'u përmendur është tregtari nga Voskopoja, Anton Kruta, i cili në vitet 1760 ishte përkthyes i ambasadorit të mbretit të Polonisë, Stanislas August Poniatowski, në negociatat me osmanët. Për më shumë shih: Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës 1669-1769* (Tiranë: Toena, 2010), 61, 67, 73.

<sup>7</sup> Ibrahim Manzur Efendiu, *Kujtime për Ali Pashën* (Tiranë: Globus R, 2003), 50.

<sup>8</sup> Po aty, 63.

tjera bujqësore e blegtorale, madje më shumë se sa në tregjet e njëjta të Berlinit, të Vjenës dhe të Parisit.<sup>9</sup>

Në Perandorinë Osmane, kadiu, duke u mbështetur në të drejtën kuranore, mund të ndërhynte edhe në caktimin e çmimeve të produkteve ushqimore. Kështu në një nga regjistrat e kadiut të Sofjes, të vitit 1744, disa nga çmimet e produkteve ushqimore ishin si në vijim: 180 dërhem (580 gramë) bukë kushtonte 1 akçe; 1 okë (1.282 kilogram) mish i dhenve kushtonte 10 akçe; 1 okë mish i viçit (lopës) kushtonte 4 akçe; 1 okë yndyrë e dhenve kushtonte 12 akçe; 1 okë yndyrë e lopës kushtonte 10 akçe; 1 okë fasule kushtonte 11 akçe; 1 okë oriz kushtonte 11 akçe; 1 okë mjaltë kushtonte 16 akçe; 1 okë pestil nga shira e rrushit kushtonte 20 akçe; 1 okë nisheste kushtonte 27 akçe etj.<sup>10</sup> Në vitin 1717, çmimet e produkteve ushqimore në Perandorinë Osmane të llogaritura në paund sterlina të Anglisë (sipas këmbimit valutor të vitit 1709; 125 kurush osmane vlenin 18 paund sterlina), kishin këtë vlerë: buka kushtonte një akçe ose  $\frac{1}{4}$  penny ; 1 okë mish kushtonte 10 akçe ose 3 penny; 1 okë fasule 11 akçe ose 3 penny, etj.<sup>11</sup> Ndërkohë në Anglinë e shekullit XVIII, që atëherë kishte 5.5 milionë banorë, buka dhe produktet nga gruri që shpenzonte një banor për një vit kushtonin 0.79 paund sterlinë.<sup>12</sup> Nëse bëjmë krahasimin e njëjtë të shpenzimeve në Perandorinë Osmane vijmë deri te të dhënat sipas së cilave një banor i kësaj perandorie shpenzonte një akçe osmane ose 0.25 penny në ditë për 180 dërhem (580 gramë) bukë dhe nëse këtë vlerë e shumëzojmë me 365 ditë, vijmë në përfundim se një banor shpenzonte 91.25 penny apo 7.5 shilling ose 0.375 paund anglezë.<sup>13</sup> Pra, në Perandorinë Osmane, në gjysmën e dytë të shekullit XVII dhe në fillim të atij XVIII, artikulli themelor ushqimor - buka, kushtonte përgjysmë më lirë sesa në Angli. Kjo do të thotë se për një

<sup>9</sup> Fernand Braudel, *The Structures of Everyday Life*, Vol. I (New York: Harper & Row, 1981), 199.

<sup>10</sup> НИКОЛАЙ ТОДОРОВ & МАРИЯ КАЛИЦИН, ТУРСКИ ИЗВОРИ ЗА БЪЛГАРСКАТА ИСТОРИЯ, VI, (СОФИЯ: БЪЛГАРСКА АКАДЕМИЯ НА НАУКИТЕ, ИНСТИТУТ ЗА БАЛКАНИСТИКА, 1977), 359. Në Perandorinë Osmane, njësia matëse oka, ishte e barabartë me 1.282 kilogramë, kurse dërhemi, ishte e barabartë me 3.207 gramë. Për më shumë shih: [https://en.wikipedia.org/wiki/Ottoman\\_units\\_of\\_measurement](https://en.wikipedia.org/wiki/Ottoman_units_of_measurement), Qasja më 21 qershor 2017.

<sup>11</sup> <http://www.pierre-marteau.com/currency/converter/tur-eng.html>, Qasja më 16 gusht 2016.

<sup>12</sup> <http://www.johnhearfield.com/History/Breadt.htm>, Qasja më 16 gusht 2016.

<sup>13</sup> <http://www.pierre-marteau.com/currency/converter/tur-eng.html>, Qasja më 16 gusht 2016.

banor të zakonshëm të kësaj periudhe historike dhe për të cilin s'kishte rëndësi ideali i shtetit-komb dhe të drejtat e njeriut por normat religjioze dhe sigurimi i mbijetesës ekonomike, jeta në Perandorinë Osmane vazhonte të ishte shumë herë më e lehtë.

Ndërkohë, në fund të shekullit XVII sistemi monetar osman ishte goditur rëndë nga vërshimi në masë i argjendit të lirë nga Amerika. Kriza fiskale dhe mbyllja e shumë minierave të argjendit kishte sjellë deri te mungesa e parasë së argjendit - akçes në gjithë Perandorinë Osmane. Kjo para e argjendit osmane, pra akçe, nga shekujt XVII-XVIII filloi të përdorej vetëm si njësi llogaritëse apo krahasuese me vlerën e parave të huaja, si dukati venedikas, reali spanjoll apo isolleta polake, etj. Kështu, më 1731, dukati venedikas kishte vlerën e barabartë me 385 akçe, ndërsa reali spanjoll me 181 akçe, etj. Rrjedhimisht, pagesat me para të huaj u bënë formë e zakonshme e pagesës në Perandorinë Osmane. Në zonat ballkanike dominonte monedha e arit venedikas; dukati dhe paraja e argjendit spanjolle; 8-real ose si quhej ndryshe "royal gurush".<sup>14</sup> Në kushtet e shthurjes së sistemit monetar osman, tregtarët venedikas, holandezë, anglezë dhe francezë sillnin me anije sasi të mëdha të parave të argjendit që nuk përmbanin sasinë e duhur të argjendit. Sjellja e këtyre parave nga tregtarët e huaj në Perandorinë Osmane ndihmoi pasurimin e këtyre tregtarëve në dëm të ekonomisë së Perandorisë Osmane, duke shkaktuar inflacion. Në këto rrethana të krizës ekonomike, Porta e Lartë futi në përdorim njësinë e re monetare "kurush" (piastër), njësi kjo e barabartë me 40 para apo 120 akçe.<sup>15</sup> Në vitin 1709 një paund sterlinë kishte vlerën e 6 kurushëve e 34 parave (113 akçe) osmane.<sup>16</sup> Këto të dhëna tregojnë për një periudhë të gjatë të zhvlerësimit të parasë osmane dhe të krizës së vazhduar ekonomike në Perandorinë Osmane.

Marrëveshjet ruso-osmane të vitit 1774 dhe të 1794, përpos që hapnin ngushticat detare për anijet tregtare ruse, gjithashtu të gjithë nënshtetasve osmanë të besimit të krishterë ortodoksë ua mundësonin lundrimin me anijet e tyre tregtare, pra me flamurin e Ruisë cariste. Të gjitha këto ndryshime ndodhnin në kohën kur në Evropë po zhvillohej lufta ndërmjet Britanisë së Madhe dhe Francës revolucionare. Në rrethana të tilla, anijet tregtare osmane e sidomos ato të grekëve, do të

<sup>14</sup> Halil Inalcik, Donald Quataert, *An Economic and Social history of the Ottoman Empire 1300-1914* (Cambridge: Cambridge University press, 1994), 962, 964, 965.

<sup>15</sup> Po aty, 966,968.

<sup>16</sup> <http://www.pierre-marteau.com/currency/converter/tur-eng.html>, Qasja më 16 gusht 2016.

merrnin rolin e transportuesve kryesorë detarë në Mesdhe. Kjo pastaj do t'ua mundësonte grekëve që jo vetëm të pasuroheshin nga tregtia ndërkombëtare, por edhe të kuptonin (ndër të parët) frymën e re evropiane, pra idetë e shtetit-komb, të revolucionit social dhe të pavarësisë kombëtare.<sup>17</sup> Dokumente të shumta arkivore na japin prova të shumta me të cilat vërtetohet se viset shqiptare nën Perandorinë Osmane, gjatë shekullit XVIII dhe gjysmës së parë të shekullit XIX, kishin një bilanc pozitiv ekonomik në tregtinë me botën e jashtme. Kështu, qarkullimi tregtar i zhvilluar në portet detare shqiptare për vitet 1770-1790, arrinte vlerën vjetore; 1.600.000 groshë për eksport, kurse për importit rreth 500.000 groshë. Në vitin 1812 nga viset jugore shqiptare eksportohehin mallra në vlerë rreth 2 milionë groshë, kurse importi nuk e kalonte vlerën e 1 milion e 200 mijë groshëve. Zonat shqiptare nën Perandorisë Osmane bilanc pozitiv tregtar kishin edhe me Maltën. Kurse raporti i ngushtë tregtar i viseve shqiptare me Venedikun më së miri ilustron me faktin se çdo vit në të dy drejtimet kishte ardhje-vajtje të 160 anijeve të mbushura me mallra të ndryshme. Në vendbanimet shqiptare, si p.sh. në fshatrat e Shkodrës, të Pejës, të Elbasanit dhe të Çamërisë, fshatarët fitonin të ardhura të mira duke kultivuar krimbin e mëndafshit. Ndërsa, gjatë sundimit të Mehmet Pashë Bushatit (Plakut) filloi edhe kultivimi i pambukut, kulturë industriale kjo shumë e përhapur në viset veriore dhe të mesme të vendbanimeve shqiptare.<sup>18</sup> Një kulturë tjetër bujqësore, e ardhur në Evropë nga Lindja e Largët, dhe pjesë e pandashme e ushqimit të përditshëm ishte edhe orizi, që përveç në disa vendbanimeve me kushte të favorshme, kultivohej edhe në krahinën e Korçës, të paktën në fillim të shekullit XIX.<sup>19</sup> Kështu, ushqimi i zakonshëm i fshatarëve shqiptarë në zonat jugore ishte buka nga gruri ose elbi, qulli ose buka nga misri, djathi i dhisë, orizi me gjalpë, vezët, ulliri dhe perimet, ndërsa verën dhe rakinë e pinin pothuaj të gjithë, edhe shqiptarët e besimit të krishterë edhe ata të besimit islam.<sup>20</sup> Zhvillimi i hovshëm ekonomik në viset shqiptare nën Perandorinë Osmane gjatë shekullit XVIII dhe gjysmës së parë të shekullit XIX, mjerisht, ishte i vonuar. Ky zhvillim po

<sup>17</sup> Joseph von Hammer, *Historija Turskog ( Osmanskog) Carstva*, III (Zagreb: Ognjen Prica, 1979), 309.

<sup>18</sup> Ligor Mile, *Zejtaria fshatare shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare* (Tiranë, 2001), 149.

<sup>19</sup> Po aty, 66.

<sup>20</sup> J. C. Hobhouse, *Journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople, during the years 1809-1810*, vol. I (Philadelphia: M. Carey and Son, 1817), 125.

ndodhte në kohën e revolucionit industrial, i cili solli përdorimin e teknologjive të reja në prodhimtari, duke shkaktuar uljen e çmimeve të shumë mallrave. Teknologjia e re ndikoi në shkatërrimin e prodhimitarisë zejtare, duke i dhënë goditje të rëndë strukturës ekonomike dhe sociale të “Portës së Lartë” si tërësi, e në veçanti, bazës ekonomike të krahinave shqiptare. Zona e parë e goditur ekonomikisht ishte pjesa më e zhvilluar e vendbanimeve shqiptare, pra ajo jugore. Megjithatë në Pashallëkun e Janinës, që në fillim të shekullit XIX e në vazhdimësi, importoheshin pambuku anglez. Pra industria e tekstitit anglez, austriak dhe italian, me çmimet e tyre të lira kishin pushtuar tërësisht tregun e këtyre viseve, duke shkatërruar plotësisht prodhimtarinë zejtare vendore.<sup>21</sup>

Një tjetër degë e zejtarisë, e njohur ndër shqiptarë, padyshim ishte edhe zeja e armëtarisë, e zhvilluar sidomos në qytetet e Prizrenit dhe në atë të Tetovës. Pushka artizanale shqiptare ishte shumë e përhapur në vitet 20 e 30 të shekullit XIX dhe njihej si karabina “kajrafile”. Me këtë lloj arme, fillimisht janë pajisur jo vetëm ushtritë e Pashallëkut të Shkodrës dhe të Janinës, por edhe ato të Serbisë dhe të Greqisë.<sup>22</sup> Mirëpo, pasi që Perandoria Osmane nuk ishte në hap me ndryshimet e reja teknologjike edhe në prodhimtarinë e armëve, zeja e armëtarisë, nga gjysma e dytë e shekullit XIX, filloi të venitet, për t’i lënë kështu rrugë armëve më moderne evropiane. Pra, me kalimin e kohës, mallrat e lira dhe cilësore të Kontinentit të Vjetër po shuanin njërin ndër sektorët e shumtë të ekonomisë prej të cilit popullsia shqiptare kishin siguruar mirëqenien materiale, ndërsa Perandoria Osmane e kishte pasur burim shtesë të të ardhurave. Në kushte të një shturjeje të aparatit administrativo-ushtarak, pushtetin në vendbanimet shqiptare e morën feudalët e mëdhenj vendorë. Njëkohësisht fillon koha e zhvendosjes së spahinjve nga zonat rurale në ato urbane, me çka forcohet roli politik i qyteteve.<sup>23</sup> Ky proces, njëkohësisht, kishte sjellë edhe anarkinë, e cila, përkundër masave centraliste të Portës së Lartë, do të mbizotëronte gjatë gjithë shekullit XIX. Nga ana tjetër, konvertimi në masë i shqiptarëve në islam, bëri që edhe ata të bëhen pjesë e elitës osmane. Si pasojë e këtij procesi, përbrenda hapësirave shqiptare do të shfaqet fenomeni i dypushtetësisë. Kështu, në njërin anë, ishin administratorët e vendosur nga ana e Portës së Lartë,

<sup>21</sup> Pukëvili, *Në Oborrin e Vezirit të Janinës*, 188.

<sup>22</sup> Po aty, 69.

<sup>23</sup> Zija Shkodra, *Qyteti Shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1984), 51.

ndërsa, në anën tjetër, qëndronte pushteti i vërtetë i familjeve të mëdha-oxhaqeve feudale shqiptare. Rrjedhimisht, shturja e brendshme dhe prapambetja teknologjike në fushën ushtarake, detyruan Portën e Lartë që t'i kushtojë rëndësi më të madhe diplomacisë.

Në fillim të shekullit XIX u bë e qartë se Perandoria Osmane territorin e saj nuk mund ta mbronte më vetëm me forcën e armëve, por, më shumë se më parë, duhej të mbështetej edhe në diplomaci. Prandaj, ajo do të përpiqet që me anën e reformave t'u afrohet shteteve të fuqishme perëndimore, në mënyrë që përsëri të bëhej ushtarakisht e aftë të vetëmbrohej dhe njëkohësisht, duke aplikuar vlerat qytetëruese të tyre, ta sigurojë mbijetesën politike. Rrjedhimisht diplomacia osmane kishte dy qëllime kryesore: ruajtjen e tërësisë territoriale dhe forcimin e pushtetit qendror në provincat të cilat kishin shprehur tendenca autonomiste apo synonin pavarësimin nga Porta e Lartë. Kjo ishte arsyeja pse Ministria e Jashtme e Perandorisë Osmane u mbush me diplomatë të rinj, të edukuar në frymën evropiane, të cilët flisnin gjuhën franceze. Madje, Porta e Lartë, gjatë gjithë shekullit XIX, insistonte te diplomatët e saj që Perandorinë Osmane të mos e paraqiste vetëm si shtet islam, por si një perandori moderne, ku të gjithë banorët ishin të barabartë para ligjit. Në këtë frymë ishte kërkesa e ambasadorit osman në Paris, Mehmet Xhemil Pashës, i cili në kohën e Luftës së Krimesë (1853-56) kërkonte nga qeveria franceze që perandorit osman të mos i drejtohej më si “Perandori i myslimanëve”, por si “Perandori Osman” ose “Lartmadhëria perandorake”. Njëkohësisht, diplomatët osmanë, në negociatat e tyre me fuqitë evropiane, më nuk do të thirreshin në ligjet islame. Arsyet e mospajtimeve të Portës së Lartë me propozimet e këtyre shteteve ata do t'i argumentonin edhe me mosmbështetjen e tyre nga ana e opinionit publik. Pra, kjo praktikë e re e diplomacisë osmane ishte armë e njëjtë sikurse ajo e diplomatëve evropianë, të cilët, në shumë raste, arsyetonin se opinionit publik i atij apo këtij shteti nuk mbështeste ndonjë marrëveshje ndërkombëtare.<sup>24</sup>

Mjerisht, përkundër të gjithave masave, Perandoria Osmane, edhe gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, vazhdonte të pësonte rënie ekonomike. Burimet ruse dëshmojnë se më 1864 Prizreni eksportonte mallra bujqësore dhe zejtare me vlerë rreth 1 milion rublash të argjendta dhe në

<sup>24</sup> Roderic H. Davison, The modernisation of Ottoman diplomacy in the Tanzimat period, *Durdu Mehmet Burak*, 863-864. file:///C:/Users/PC/Downloads/5000085509-5000119465-1-PB.pdf, Qasja më 21qershor 2016.

të njëjtën periudhë, importante mallra me vlerë rreth 500 mijë rublash. Kurse, në anën tjetër, porti detar i Vlorës kishte bilanc negativ tregtar; me mallra të importuara në vlerën prej 1 800.000 rublash, kurse të eksportuara në vlerën prej 48.0000 rublash. Në po të njëjtin vit, Durrësi kishte hyrje-dalje të 1.178 anijeve, me një peshë prej 89.966 tonësh, ku mallrat e importuara kishin vlerën prej 1 milion e 300 mijë rublave, ndërsa eksporti sillej rreth 1 milion e 500 mijë rubla.<sup>25</sup> Nga këto të dhëna komerciale rrjedhin dy përfundime kontradiktore: 1) Deri në gjysmën e parë të shekullit XIX, bilanc pozitiv tregtar kishin pothuajse të gjitha qytetet tregtare shqiptare dhe 2) edhe në fillim të viteve të shtatëdhjeta të shekullit XIX, këtë bilanc pozitiv tregtar vazhdonte ta kishte pjesërisht Prizreni. Këto të dhëna ekonomike në të vërtetë tregojnë për mungesën e zhvillimit të tregut të brendshëm, i cili ende nuk kishte rritje të kërkesave për prodhimet industriale evropiane. Pra, produktet perëndimore, duke qenë të shtrenjta për blerësin e zakonshëm, nuk e cenonin zejtarinë vendase shqiptare. Faktor plotësues që e frenonte tregtinë ishte edhe mungesa e infrastrukturës rrugore e në veçanti mungesa e plotë e vijave hekurudhore. Kështu, deri në fillim të viteve 60 të shekullit XIX, në zonat me popullsi shqiptare nuk ekzistonte asnjë lidhje hekurudhore, gjë që padyshim do të ndikonte në rritjen si të vëllimit tregtar ashtu edhe në lëvizjen e lirë dhe të shpejtë të risive teknike. Nga këto të dhëna kuptojmë se, së paku, bujqësia dhe blegtoaria evropiane ende nuk ishin të industrializuara dhe se këta sektorë ende qëndronin në pozita të njëjta me ato të Perandorisë Osmane. Ç'është e drejta, Perandoria Osmane, në kushtet e një prapambetjeje të dyanshme, me prodhimet e veta bujqësore ishte më konkurrenente me çmime se sa vendet evropiane. Mirëpo kjo gjendje do të ndryshonte shumë shpejt dhe atë në dëm të Perandorisë Osmane e të zonave të saj ballkanike. Ky ndryshim natyrisht ishte pasojë edhe e mentalitetit oriental që përbuzte punën dhe madhëronte trimërinë dhe luftën. Për shkak të kësaj mendësie edhe në vendbanimet shqiptare të Perandorisë Osmane punët për mbjelljen dhe korrijen e të lashtave detyroheshin t'i bënin gratë dhe të vjetrit, ndërsa burrat i kryenin vetëm punët që kërkonin fuqi, si prerja e druve ose kujdesi ndaj vreshtave. Pra, shqiptarët, për fatin e tyre të keq, nuk kishin kultivuar vlerat që madhëronin punën, tregtinë dhe shprehitë e prodhimit. Në vend të kësaj, sipas udhëpërshkruesit Hobhouse, malësori ose fshatari shqiptar, kur nuk ishte

---

<sup>25</sup> Po aty, 149.

i angazhuar në luftë, jetonte një jetë prej përtaci, duke pirë, duke ngrënë dhe duke tymosur duhan me llullë.<sup>26</sup>

Sidoqoftë, i gjithë ky bilanc pozitiv tregtar në gjysmën e parë të shekullit XIX, padyshim, solli një rilindje në jetën kulturore, duke sjellë në skenë një brez të ri intelektualësh shqiptarë të edukuar dhe të arsimuar në institucionet më prestigjioze të Perandorisë Osmane. Këta shkollarë, në mungesë të alfabetit kombëtar, për të shkruar në gjuhën shqipe, detyroheshin të shfrytëzonin shkronjat arabe. Pra, mungesa e shkronjave shqipe ishte komponent që pengonte sidomos ringjalljen shpirtërore dhe kombëtare të shqiptarëve të besimit islam. Kështu, bejtexhinjtë shqiptarë, me qendër kulturore në Berat, bënë hapat e parë drejt një rruge të gjatë të rizgjimit kombëtar shqiptar.<sup>27</sup> Megjithatë, shqiptarët edhe në fillim të shekullit XIX vazhdonin të ishin një faktor determinues në Perandorinë Osmane, sidomos në pjesën evropiane të saj. Për këto rrjedha ngjarjesh në tokat e banuara nga shqiptarët, opinioni publik anglez vazhdonte të informohej përmes shtypit. Kështu, në vitin 1802, gazeta “The Hampshire Chronicle” shkruante se Ali Pashë Tepelena vazhdonte t’i zgjeronte territoret e tij në përpjekje për t’i bashkuar zonat shqiptare dhe për të formuar një shtet të pavarur nga Porta e Lartë.<sup>28</sup> Kjo gazetë bënte fjalë edhe për praninë e anijeve amerikane në detin Mesdhe dhe për përballjen e tyre me piratët afër Tripolit. Po ashtu, ajo bënte të ditur edhe për vendimet e gjyqit ushtarak të zhvilluar në anijen “Centaur” kundër tre marinarëve të rebeluar të anijes bregdetare shqiptare, njëri prej të cilëve ishte dënuar me 300 të goditura me kamxhik.<sup>29</sup> Në vitin 1802, po nga Vjena, njoftonin se për arsye të vonimit të pagesave për forcat lokale të angazhuara në Kotorr të Dalmacisë dhe në disa vendbanime të tjera shqiptare, kishin shpërthyer pakënaqësitë, për çka nga Trieshta ishte lëshuar urdhri që të dërgoheshin të hollat për pagimin e trupave shqiptare.<sup>30</sup> Ndërsa gjatë vitit 1802-1803, me tërheqjen e trupave britanike nga

<sup>26</sup> J. C. Hobhouse, *Journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople, during the years 1809-1810*, vol. I (Philadelphia: M. Carey and Son, 1817), 126.

<sup>27</sup> Historia e Popullit Shqiptar, I, 385.

<sup>28</sup> The British Library, British Newspaper Archive (më tutje: BL, BNA), *Hampshire Chronicle (Hampshire, England)*, Monday, 24 May, 1802.

<sup>29</sup> BL, BNA, *Hampshire Chronicle (A Weekly Advertiser for the counties Southempton, Sussex, Surrey, Berks, and Dorset, Hampshire, England)*, Monday, 04 October, 1802, 4.

<sup>30</sup> BL, BNA, *Hampshire Chronicle (A Weekly Advertiser for the counties Southempton, Sussex, Surrey, Berks, and Dorset, Hampshire, England)*, Monday, 09 August, 1802, 3.

Egjipti, forcat shqiptare që ishin bashkuar me mamlukët<sup>31</sup> kishin mundur ushtrinë osmane, duke i dhënë kështu një goditje të rëndë përpjekjeve të Portës së Lartë për ta rikthyer sovranitetin mbi Egjiptin.<sup>32</sup> Gjithashtu një numër i madh i shqiptarëve, me ndihmën e anijeve të ndryshe evropiane, kishin ardhur në Egjipt dhe u ishin bashkuar forcave kryengritëse shqiptare në Kajro. Lidhur me këtë problem, Kapedan Pasha i flotës osmane kishte biseduar me diplomatët evropianë në Konstandinopojë (Stamboll), duke kërkuar prej tyre që ta parandalonin transportimin e shqiptarëve.<sup>33</sup> Ndërsa ambasadori i Britanisë së Madhe në Perandorinë Osmane, William Drummond, më 7 qershor 1803, e informonte kryetarin e Këshillit për Tregti, Lord-in Hawkesbury, mbi situatën e përgjithshme në Perandorinë Osmane. Ambasadori Drummond shprehte mospajtimin me mënyrën e zgjidhjes së problemeve që krijoheshin me rastin e rebelimit në perandori nga ana e Portës së Lartë. Sipas tij, Porta e Lartë kryengritjen e shqiptarëve në Egjipt, kishte vendosur ta zgjidhte duke pranuar që t'i paguante ata, gjë që linte hapësirë për çrregullime të reja në ushtri. Gjithashtu, po sipas këtij ambasadori, pushteti osman në pjesën evropiane të saj mbahej vetëm falë frikës së Ali Pashë Tepelenës nga kundërshtarët e tij, si Paswan Oglou, Pashait të Delvinës dhe atij të Selanikut.<sup>34</sup>

Gazetat angleze, gjatë vitit 1803, lajmëronin edhe për emigrimin në masë të zviceranëve për në SHBA. Bile gjenerali francez në Zvicër, Mishel Ney, kishte kërkuar nga Qeveria Helvetike (Zvicerane) që të merrte masa për të parandaluar dukurinë e shpërnguljeve në masë. Si dëshmi të largimit në masë të zviceranëve, gazeta “Bell’s Weekly Messenger” theksonte se vetëm në tre ditë, shtetasit e kësaj republike, pasi ishin pajisur me 800 pasaporta, menjëherë kishin emigruar. Po kështu, shtypi anglez njoftonte se 600 ushtarë zviceranë të stacionuar në Korsikë ishin larguar për në ishullin Shën Domingo të kontinentit amerikan.<sup>35</sup> Ndërsa në janar të vitit 1804, gazeta “Aberdeen Journal” njoftonte për

<sup>31</sup> Mamelukët ishin ushtri e përbërë nga skllavët, të cilët në Egjipt kishin krijuar sulltanatin e tyre, dhe që edhe pas kalimit nën sundimin osman, kishin vazhduar të ekzistonin si shtresë me ndikim. Shih: <https://www.britannica.com/topic/Mamluk>. Qasja më 4 dhjetor 2021.

<sup>32</sup> BL, BNA, *Hampshire Chronicle (A Weekly Advertiser for the counties Southampton, Sussex, Surrey, Berks, and Dorset, Hampshire, England)*, Monday, 10 October, 1803, 2

<sup>33</sup> BL, BNA, *Morning Chronicle*, Thursday, 24 November, 1803, 3

<sup>34</sup> Христо Андонов- Полјански, *Британски Документи за Историјата на Македонскиот Народ 1797-1839*, Том I (Скопје: Архив на Македонија, 1968), 180-181.

<sup>35</sup> BL, BNA, *Bell’s Weekly Messenger (London, England)*, no. 362, Sunday, 20 March, 1803, 1.

emërimin e John Philip Morier-it konsull të Britanisë së Madhe në Shqipëri dhe More.<sup>36</sup> Ky interesim britanik për shqiptarët do të thoshte se ata ishin një faktor përcaktues në kuadër të Perandorisë Osmane dhe se pashallarët shqiptarë ishin edhe subjekt aktiv në arenën ndërkombëtare. Lidhur me thellimin e raporteve tregtare ndërmjet Britanisë së Madhe dhe zonave të banuara me shqiptarë, konsulli Morier shkruante se nga këto vise do të mund të importoheshin edhe rushi pa fara ose stafidhet, bimë kjo shumë e pasur me vitaminën C. Mirëpo, vazhdonte ai raportin e tij, rritja e këmbimit tregtar me këto vise bëhej e pamundur për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore dhe për shkak të varfërisë së banorëve.<sup>37</sup>

Ndërsa në fund të vitit 1804 vinin lajme se në portin detar të Sevastopolit në Detin e Zi, një ushtri e madhe ruse, që destinacion përfundimtar kishte ishullin e Korfuzit, ishte në pritje të anijeve. Porta e Lartë, në kushte të luftës, kur edhe shpenzimet ushtarake ishin rritur pamasë, ishte e detyruar që t'i rriste taksat dhe të merrte masa për mbledhjen e tyre. Natyrisht, masat e tilla shtrënguese në përpjekje për të mbushur buxhetin perandorak kishin goditur edhe zonat e banuara me shqiptarë. Gazeta "Caledonian Mercury", në vitin 1804, shkruante se popullsia shqiptare ishte ndër më luftaraket dhe ndër më të shkathëtat në Kontinentin e Vjetër, me një shkallë të lartë të autonomisë dhe të cilën Porta e Lartë asnjëherë nuk kishte guxuar ta kontestonte. Ndër të drejtat e privileguara të tyre, sipas këtij shkrimi, ishte edhe mercenarizmi për nevoja të cilësdo fuqie që ata, pra shqiptarët, e konsideronin më të favorshëm. Shqiptarët, vazhdonte kjo gazetë, e kanë dëshmuar veten e tyre se janë ushtarë besnikë, aktivë dhe të qëndrueshëm, për çka një numër i konsideruar i tyre ishin angazhuar si mercenarë edhe nga ana e Ruisë cariste. Mirëpo, duhet thënë se ky rekrutim me pagesë i shqiptarëve nga ana e rusëve ishte bërë i mundshëm pikësepari duke iu falënderuar raporteve të tendosura ndërmjet Portës së Lartë dhe Francës, si dhe ndikimit të madh që Petersburgu kishte në Stamboll. Njëkohësisht, Porta e Lartë, nën ndikimin, përsëri, të Ruisë cariste, kishte refuzuar të pranonte Napoleon Bonapartën si perandor të barabartë me Sulltanin. Kjo ishte një fyerje që Napoleon Bonaparta nuk do harronte.<sup>38</sup> Të dhënat e

<sup>36</sup> BL, BNA, *Aberdeen Journal (Aberdeenshire, Scotland)*, no. 2921, Wednesday, 04 January, 1804, 2.

<sup>37</sup> Христо Андонов- Полјански, *Британски Документи за Историјата на Македонскиот Народ*, 188.

<sup>38</sup> BL, BNA, *Caledonian Mercury (Midlothian, Scotland)*, Monday, 19 November, 1804, 3.

bollshme arkivore dëshmojnë se shqiptarët deri në fund të shekullit të XVIII dhe në dekadën e parë të shekullit XIX konsideroheshin si nga ana e Portës së Lartë ashtu edhe nga Fuqitë Evropiane si faktor përcaktues në jetën politike dhe ushtarake të Ballkanit osman.

### **Summary**

The era of territorial expansion of the Ottoman Empire had ended with the Peace of Karlovac (1699) as well as with the Treaty of Kyçyk Kainarxhi (1774) and had begun the period of intervention of European countries in internal affairs of the Sublime Porte. Meanwhile, in the Albanian areas under the Ottoman Empire, the economic and social situation of the population was aggravated and an additional factor in the deterioration, especially of the peasants position, was the process of spreading private property, thus increasing the illegal taxes on peasants. Consequently a small opportunity for employment of this warlike population was to enter military service, either as volunteer-mercenaries, or as imposed by the empire or even by powerful local feudal lords. On the other hand, at the end of the 18th century and the beginning of the 19th century, in the areas inhabited by Albanians were created autonomous pashaluks, who were only formally subject to the sultan.

## BIBLIOGRAFIA

### BURIME ARKIVORE

#### **The British Library, British Newspaper Archive:**

- *Hampshire Chronicle (Hampshire, England)*, Monday, 24 May, 1802.
- *Hampshire Chronicle (A Weekly Advertiser for the counties Southampton, Sussex, Surrey, Berks, and Dorset, Hampshire, England)*, Monday, 04 October, 1802.
- *Hampshire Chronicle (A Weekly Advertiser for the counties Southampton, Sussex, Surrey, Berks, and Dorset, Hampshire, England)*, Monday, 09 August, 1802.
- *Morning Chronicle*, Thursday, 24 November, 1803.
- *Bell's Weekly Messenger (London, England)*, no. 362, Sunday, 20 March, 1803.
- *Aberdeen Journal (Aberdeenshire, Scotland)*, no. 2921, Wednesday, 04 January, 1804.
- *Caledonian Mercury (Midlothian, Scotland)*, Monday, 19 November, 1804.

### DOKUMENTE TË BOTUARA ARKIVORE

1. ТОДОРОВ, НИКОЛАЙ & МАРИЯ КАЛИЦИН. ТУРСКИ ИЗВОРИ ЗА БЪЛГАРСКАТА ИСТОРИЯ, VI. СОФИЯ: БЪЛГАРСКА АКАДЕМИЯ НА НАУКИТЕ, ИНСТИТУТ ЗА БАЛКАНИСТИКА, 1977.
2. Полјански, Христо Андонов. *Британски Документи за Историјата на Македонскиот Народ 1797-1839*, Том I. Скопје: Архив на Македонија, 1968.

### LITERATURA

1. Anscombe, F. Frederic. *The Ottoman Balkans 1750-1830*. Princeton: Markus Wiener Publishers, 2006.

2. Anastasopoulos, Antonis and Elias Kolovos, ed. *Ottoman rule and the Balkans (1760-1850): Conflict, Transformation, Adaptation*. Rethymno: University of Crete, 2007.
3. Braduel, Fernand. *The Structures of Everyday Life*, Vol. I. New York: Harper & Row, 1981.
4. *Historia e popullit Shqiptar*, vëll. I . Prishtinë: Rilindja, 1979.
5. Hobhouse, J. C. *Journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople, during the years 1809-1810*, vol. I. Philadelphia: M. Carey and Son, 1817.
6. Inalcık, Halil and Donald Quataert. *An Economic and Social history of the Ottoman Empire 1300-1914*. Cambridge: Cambridge University press, 1994.
7. Krasniqi, Memli & Flamur Ukaj. "Gjendja shëndetësore në viset shqiptare gjatë luftërave osmano-austriake në shekujt XVII-XVIII, " *Studime Historike*, no.1-2 . Tiranë: QSA-Instituti i Historisë, 2015.
8. Miller, William. *The Ottoman Empire 1801- 1913*. Cambridge: University Press, 1913.
9. Manzur Efendiu, Ibrahim . *Kujtime për Ali Pashën*. Tiranë: Globus R , 2003.
10. Mile, Ligor. *Zejtaria fshatare shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare*. Tiranë, 2001.
11. Pukëvili, Fransua. *Në Oborrin e Vezirit të Janinës*. Tiranë, 1999.
12. Shkodra, Zija. *Qyteti Shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1984.
13. Von Hammer, Joseph. *Historija Turskog (Osmanskog) Carstva*, III. Zagreb: Ognjen Prica, 1979.
14. Xhufi, Pëllumb. *Shekulli i Voskopojës 1669-1769*. Tiranë: Toena, 2010.

#### BURIME ELEKTRONIKE

1. <http://www.pierre-marteau.com/currency/converter/tur-eng.html>.
2. <http://www.johnhearfield.com/History/Breadt.htm>.
3. Davison, Roderic H. The modernisation of Ottoman diplomacy in the Tanzimat period, *Durdu Mehmet Burak*.  
file:///C:/Users/PC/Downloads/5000085509-5000119465-1-PB.pdf